



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 399 prot.

Tiranë, më 05. 03. 2024

**V E N D I M**

**Nr. 54, datë 05. 03. 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma b), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 156 Regj., datë 10.08.2023, të Fondacionit “Së Bashku”, kundër Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Tirana International Airport sh.p.k. dhe Star Parking Albania sh.p.k., me pretendimin për diskriminim të personave me aftësi të kufizuar, lidhur me garantimin e vendeve të parkimit pa pagesë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>1</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit pala ankuese shpjegon se, nga një vizitë e bërë së fundmi në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, në Rinas, kanë konstatuar dhe janë informuar se personat me aftësi të kufizuara nuk lejoheshin të parkonin makinat pa pagesë, siç ndodhte më parë. Sipas pretendimeve të subjektit ankues, ky ndryshim ka ndodhur së fundmi, pasi më parë personat me aftësi të kufizuar parkonin automjetet pa pagesë brenda Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, në Rinas.

Gjithashtu, pretendohet se edhe ato në ato vende parkimi që janë të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, këta të fundit nuk mund të parkojnë për shkak se janë të zëna nga individ të tjerë. Në pretendim tjetër i ngritur nga ana e subjektit ankues është edhe fakti që personat me aftësi të kufizuar nuk mund të parkojnë pa pagesë për periudha afatgjata.

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara nga ana e Tirana International Airport Shpk, kompania që administron parkimin e saj dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe:

- Anullimin e vendimit nga ana e kompanisë që administron parkimin në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, në Rinas, duke hequr tarifat për personat me aftësi të kufizuara;
- Shtimin e numrit të vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, në afërsi të hyrjes së aeroportit, të cilat të përmbushin plotësisht standardet e aksesueshmërisë;
- Parkimin pa pagesë të personave me aftësi të kufizuara edhe për periudha afatgjata, disa ditore.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma b), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>2</sup>, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat e paraqitura nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm, për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Në këtë rast që kjo palë të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të çenohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: “Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”

Nga aktet e administruara rezulton se, Fondacioni “Së Bashku” është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 427, datë 18.06.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur, Fondacioni “Së Bashku” nuk pretendon se është cenuar në interesin e tij të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara për mosgarantimin e vendeve të parkimit pa pagesë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Tirana International Airport sh.p.k. dhe Star Parking Albania sh.p.k.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Fondacioni “Së Bashku”, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin që t’u përgjigjet nevojave të grupeve të përjashtuara në Shqipëri, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

**Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Në vijim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 932/1 prot., datë 14.08.2023, i është drejtuar Shoqërisë Tirana International Airport shpk dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, duke kërkuar informacion sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues.

Në përgjigje përsa më lart, Tirana International Airport Shpk përmes shkresave<sup>3</sup> nr. 795/1 prot., datë 17.08.2023 dhe nr. 795/2 prot., datë 25.08.2023, informoi Komisionerin për

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me nr. 932/2 prot., datë 28.08.2023 dhe nr. 932/2 prot., datë 28.08.2023.

Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me parashtrimet e saj sa i përket ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, duke theksuar ndër të tjera se: “...TIA, në cilësinë e shoqërisë koncesionare të Aeroportit të Tiranës, garanton se nuk ka marrë asnjëherë ndonjë ankesë lidhur me këtë çështje nga personat e interesuar qoftë drejtpërdrejtë pranë saj, qoftë edhe nëpërmjet Kontraktorit, që administrojnë parkimin e Aeroportit.

Në përmbajtje të shkresës, theksohet se personat me aftësi të kufizuar në ndryshim nga sa ka ndodhur më parë nuk lejohet të parkojnë pa pagesë në Aeroportin e Tiranës, nuk lejohet të parkojnë pa pagesë për periudha të gjata kohore si edhe në vendet e parkimit të rezervuar për personat me aftësi të kufizuar nuk mund të parkojnë pasi janë të zëna nga individë të tjerë. Po kështu në mënyrë të përmbledhur pala ankuese kërkon që të anulohet vendimi nga ana e kompanisë që administrojnë parkimin në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, në Rinas, duke hequr tarifën për personat me aftësi të kufizuar; shtimin e numrit të vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar, në afërsi të hyrjes së aeroportit të cilat të përmbushin plotësisht standardet e aksesueshmërisë si dhe parkimin pa pagesë të personave me aftësi të kufizuar edhe për periudha afatgjata, disa ditore.

Ndërkohë, TIA për sa takon çështjes në fjalë, kërkon të parashtrijë argumentet dhe informacionin që ajo disponon mbi këtë çështje në cilësinë e shoqërisë që administrojnë dhe operon në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës duke qenë gjithmonë e fokusuar në ruajtjen e cilësisë në të gjitha kategoritë e shërbimeve që ofrohen në Aeroportin e Tiranës, përfshirë dhe atë të parkimit.

Konkretisht, TIA me anë të Kontratës së Koncesionit lidhur me datë 01.07.2015 (“Kontrata”) me shoqërinë Star Parking Albania SHPK (këtu e më poshtë referuar Shoqëria) i ka dhënë me nën-koncesion kësaj të fundit, të drejtën e menaxhimit, instalimit, përditësimit/përmirësimit dhe operimit të përhershëm të parkimit në Aeroportin e Tiranës, ku përfshihet instalimi dhe komisionimi i gjithë sistemit dhe pajisjeve të parkimit, operimi/administrimi, vendosja e tarifave, aksesit si dhe përdorimi i faciliteteve të parkimit.

Në këtë drejtim, neni 3.3 i Kontratës përcakton se Shoqëria në drejtim të ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve që jepen me anë të kësaj Kontrate është një kontraktor/pavarur, që vepron në emër dhe për llogari të tij dhe nuk do të veprojë si agjent ose partner i TIA-s. Thënë këtë, TIA kërkon të sqarojë se çdo përgjegjësi për administrimin e parkimit në Aeroportin e Tiranës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi është dhe mbetet gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës një përgjegjësi unike dhe e vetme e Shoqërisë Star Parking Albania shpk. Shoqëria ka detyrimin të marrë parasysh në administrimin e parkimit në aeroport detyrimet ligjore në këtë fushë dhe konkretisht Vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008 që përcakton rregullat mbi shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar.

Megjithatë TIA me vënien në dijeni të ankesës së adresuar nga Komisioneri përcolli pranë Shoqërisë ankesën me anë të një shkrese të veçantë (këtu bashkëlidhur) duke kërkuar informacion të hollësishëm prej saj si Shoqëria direkt përgjegjëse për menaxhimin e parkimit.

Shoqëria ka kthyer përgjigje duke na dhënë informacion mbi çështjen në diskutim (bashkëlidhur përgjigja e Shoqërisë). Në mënyrë të përmbledhur ajo ka sqaruar se nuk ka patur asnjë ankesë nga personat me aftësi të kufizuar. Ndër të tjera ajo sqaron se gjithmonë personat me aftësi të kufizuar nuk kanë paguar tarifën e parkimit pavarësisht kohës së

*parkimit dhe pavarësisht vendit se ku kanë parkuar, në vend të rezervuar personave me aftësi të kufizuar apo jo, mjafton që të tregojnë dokumentin e kërkuar ligjor për të vërtetuar statusin e tyre si person me aftësi të kufizuar dhe ata nuk paguajnë në asnjë rast tarifën e parkimit qoftë edhe për parkim disa ditore.*

*Po kështu në shkresën e tyre sqarohet se Shoqëria nuk ka ndryshuar asnjëherë politikën e saj lidhur me tarifimin e personave me aftësi të kufizuar dhe cilësohet se ajo është shumë e përgjegjshme në këtë drejtim. Aktualisht edhe pse ka 4 vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar, në afërsi të Terminalit të Pasagjerëve, personat me aftësi të kufizuar janë lejuar të parkojnë edhe në vende të tjera që nuk iu janë rezervuar atyre duke mos paguar asnjëherë tarifën dhe se në parkimin e ri që po ndërtohet në Aeroportin e Tiranës do të sigurohen si numrat e vendparkimeve të rezervuar falas ashtu edhe të gjitha kushtet e aksesueshmërisë për këtë kategori, sipas Vendim nr. 1503, datë 19.11.2008.*

*TIA, megjithëse mbetet e gatshme për tu ofruar çdo informacion dhe/ose dokumentacion shtesë me qëllim sqarimin e çdo pyetje apo paqartësie, ju fton të kontaktoni drejtpërdrejtë Shoqërinë Star Parking Albania SHPK si shoqëri përgjegjëse për administrimin e parkimit të Aeroportit të Tiranës”.*

Gjithashtu, bashkëngjitur shkresës Nr. 795/1, datë 17.08.2023, Tirana International Airport Shpk, përcolli përgjigjen e Shoqërisë Star Parking Albania, e cila mban datën 22.08.2023, ku ndër të tjera citohej se: “Së pari ne si Star Parking Albania nuk kemi marrë asnjë ankesë verbale ose shkresore nga ana e ndonjë personi me aftësi të kufizuara (invalid).

*Nuk ekziston asnjë vendim i kompanisë Star Parking, i cili të ngarkojë me tarifën e parkingut personat me aftësi të kufizuara.*

*Në projektin e ri janë parashikuar vendparkimet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara sipas Vendimit Nr. 1503, datë 19.11.2008 “Për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”. Aktualisht jemi në fazën e zhvillimit të projektit (në ndërtim e sipër) dhe deri në përfundim do të përmbushen plotësisht standardet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.*

*Pavarësisht nga periudha e qëndrimit, personat me aftësi të kufizuara kanë përfutur dhe do të përfutojnë parking me tarifën “0”.*

*Në lidhje me sa kërkohet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund t’ju themi:*

*Ne nuk kemi ndonjë argumentim të veçantë për rastin në fjalë pasi siç theksuam dhe më lart nuk administrojmë as një lloj ankimi nga askush. Star Parking Albania u njoh me këtë ankesë vetëm nëpërmjet emailit tuaj.*

*Kur paraqiten persona me aftësi të kufizuara ne i kërkojmë dokumentacionin përkatës që vërteton qenien e tyre me status invalid dhe pas verifikimeve përkatëse ne zbatojmë legjislacionin në fuqi në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës në lidhje me rastet në fjalë.*

*Në pjesën e mbuluar të parkingut P1 (pika më afërt me Terminalin) janë të aksesueshme 4 (katër) poste të dedikuara për personat me aftësi të kufizuar të cilët janë lehtësisht të identifikueshëm nga tabelat përkatëse.*

*Ndryshimet e tarifave në parkingun e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës nuk kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuar, pasi siç theksuam më lart janë të përjashtuar nga çdo taksë apo tarifë.*

*Në përmbledhje të çka u tha më sipër, ju sjellim dhe një herë në vëmendjen tuaj që nuk ka patur asnjë ndryshim me politikën e përhershme në lidhje me personat me aftësi të kufizuara në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Ne do vazhdojmë si gjithmonë të kemi me përparësi në punën tonë problemet e personave me aftësi të kufizuar.”*

Bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, Star Parking Albania vuri në dispozicion foto të vendparkimeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuar në Parkingun Nr. 1 dhe Nr. 2, si dhe një biletë parkimi, përmes së cilës një person me aftësi të kufizuar kishte përfutur parkimin pa pagesë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

2. Në këto kushte, Komisioneri me anë të e-mail-it datë 28.08.2023, i përcolli subjektit ankues parashtrimet e Tirana International Airport Shpk. Në përgjigje të këtij e-maili Fondacioni “Së Bashku”, me e-mail-in datë 31.08.2023, informoi Komisionerin lidhur me pretendimet e tyre sa i përket shkresave të sipërcituara, duke përcjell gjithashtu edhe disa video dhe foto në cilësinë e provës.
3. Sakaq, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me anë të shkresës Nr. 932/4 prot., datë 18.09.2023 i përcolli Shoqërive Tirana International Airport shpk dhe Star Parking Albania shpk një kopje të përgjigjes së Fondacionit “Së Bashku”, duke vënë në dispozicion të tyre fotot dhe videot e depozituara në cilësinë e provës, si dhe kërkoi parashtrime shtesë lidhur me pretendimet e palës ankuese. Gjithashtu, kërkoi nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, nëse ka zhvilluar ndonjëherë monitorime sa i përket pretendimeve të ngritura nga subjekti ankues, lidhur me garantimin e vendeve të parkimit pa pagesë për personat me aftësi të kufizuara.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, TIA informoi Komisionerin me shkesën<sup>4</sup> Nr. 795/5 prot., datë 16.10.2023, ndër të tjera se: “...Me anë të kësaj shkrese, TIA konfirmon se është vënë në dijeni të ankesës së Fondacionit “Së Bashku” për problematikat e hasura në aksesin falas të vendparkimeve të aeroportit së bashku me videot dhe fotot në cilësinë e provës.

*Në këtë drejtim, TIA dëshiron t’ju bëjë me dije se ka kontaktuar përsëri me Shoqërinë Star Parking Albania (Koncesionarin e Parkimeve) duke riadresuar problematikat e rastit në fjalë si dhe i ka kërkuar marrjen e masave për ndreqjen e situatës.*

*Por është e rëndësishme të analizojmë disa aspekte ligjore të Kontratës së Koncesionit të vendparkimeve në aeroport me qëllim për të kuptuar drejt pozicionin e TIA-s në garantimin e të drejtës të personave me aftësi të kufizuara për të pasur akses falas në vendparkimet e aeroportit sipas parashikimeve ligjore në fuqi.*

*Së pari, siç edhe jeni informuar nga TIA shkresërisht, kjo e fundit e ka dhënë me koncesion shërbimin e menaxhimit të vendparkimeve në Aeroportin e Rinasit me anë të*

---

<sup>4</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 932/6 prot., datë 20.10.2023



*Marrëveshjes së Amenduar dhe Rikonfirmuar e Parkimit dhe të Karrocave (Marrëveshja) hyrë në fuqi më datë 01.07.2015 kompanisë Star Parking Albania shpk (Shoqëria).*

*Sipas kësaj Marrëveshje, Shoqëria gëzon të drejta të plota të menaxhimit, finalizimit, përmirësimit, përditësimit dhe operimit të përhershëm, vendosjes së tarifave, aksesit, përdorimit të faciliteteve (day-to-day business) të vendparkimeve në aeroport përgjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes në fjalë.*

*Marrëveshja ka pjesë integrale të saj Marrëveshjen e Koncesionit të Aeroportit ratifikuar me Ligjin nr. 9312/2004, me qëllim që Shoqëria duke qenë se ka statusin e kontraktorit të pavarur nga TIA, siç e specifikon dhe neni 3.3 i Marrëveshjes, të respektojë të drejtat e detyrimet që burojnë nga Ligji 9312/2004 përpara palëve të treta sikur të ishte vetë TIA.*

*Së dyti, duam të theksojmë se Shoqëria sipas nenit 17 të Marrëveshjes, është përgjegjëse të veprorë në çdo kohë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat në fuqi, të zbatojë praktikën e rekomanduar në përgjithësi dhe ato të dedikuara për aeroportin. Për shkak se Shoqëria është plotësisht e pavarur në administrimin e vendparkimeve pa asnjë lidhje partneriteti apo agjenti, në Marrëveshjen me Shoqërinë, TIA ka theksuar detyrimin e saj të respektojë në operimin e përditshëm, të gjithë kuadrin ligjor, neni 18.4 i Marrëveshjes përcakton se ajo është tërësisht përgjegjëse për çdo shkelje përfshirë dhe shkeljen e kuadrit ligjor të kryer nga vetë ajo, punonjësit apo nënkontraktorët e saj. Pra, referuar Marrëveshjes, neni 17 dhe neni 18.4 rezulton se përgjegjësitë që lindin nga shkeljet e rregullave në fuqi, bien tërësisht mbi Shoqërinë, kjo pasi TIA nuk është përfshirë në asnjë lloj forme në administrimin e vendparkimeve të aeroportit.*

*Së fundmi, në përmbledhje të sa më sipër, donim të parashtronim se:*

- TIA nuk është shoqëria përgjegjëse, e drejtpërdrejtë që me veprimet apo mosveprimet e saj apo politikën e rregullat e saj të administrimit të ndikojë në lindjen e problematikës që ngre Fondacioni “Së Bashku”; si dhe,*
- TIA nuk gëzon asnjë autoritet dhe apo kompetencë mbikëqyrëse mbi Shoqërinë për të imponuar politika apo direktiva të caktuara në realizimin e menaxhimit të përditshëm të biznesit;*

*TIA, me marrjen dijëni të problematikës në fjalë, i është drejtuar përsëri Shoqërisë dhe i ka kërkuar marrjen e masave për ndreqjen e situatës së krijuar si dhe respektimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e vendparkimeve në përputhje me Vendimin Nr. 1503, datë 19.11.2008, duke i kujtuar përgjegjësitë që ajo ka sipas Marrëveshjes mes dy palëve.*

*Për sa më lart, TIA kërkon mirëkuptimin tuaj dhe ndjekjen e problematikës në fjalë me Shoqërinë Star Parking Albania Shpk si pala e vetme e përfshirë drejtpërdrejtë në situatën e krijuar duke garantuar se mbështet çdo veprim tuajin në zbatim të ligjit.”*

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me anë të shkresës<sup>5</sup> nr. 6653/2 prot., datë 02.10.2023, drejtuar TIA-s dhe për dijëni Komisionerit, informoi ndër të tjera se: “...Pala ankuese ndër të tjera pretendon se, në Aeroportin

<sup>5</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 932/5 prot., datë 03.10.2023.

*Ndërkombëtar të Tiranës, për këtë kategori personash, nuk mundësohet parkimi pa pagesë për mjetet e tyre, si dhe vendet e parkimit që janë rezervuar për këtë kategori, nuk janë të lira, duke krijuar vështirësi për aksesin e tyre.*

*Sa më sipër, duke qenë se parkimi i Aeroportit është në administrim të shoqërisë “Tirana International Airport” shpk, kërkojmë nga ana juaj një informacion të plotë dhe shterues lidhur me këtë çështje dhe mundësinë për zgjidhjen e situatës së krijuar”.*

Me shkresën<sup>6</sup> Nr. 6653/4 prot., datë 07.11.2023, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...Shërbimi i menaxhimit të vendparkimeve në Aeroportin e Rinasit, është dhënë me koncesion nga TIA kompanisë Star Parking Albania shpk, me anë të Marrëveshjes së parkimit dhe karrocave, e ndryshuar, hyrë në fuqi datë 01.07.2015.

*Sipas kësaj Marrëveshje, Shoqëria gëzon të drejta të plota të menaxhimit, finalizimit, përmirësimit, përditësimit dhe operimit të përhershëm, vendosjes së tarifave, aksesit, përdorimit të faciliteteve (day-to-day business) të vendparkimeve në aeroport përgjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes në fjalë.*

*Marrëveshja ka pjesë integrale të saj Marrëveshjen e Koncesionit të Aeroportit ratifikuar me Ligjin nr. 9312/2004 me qëllim që Shoqëria duke qenë se ka statusin e kontraktorit të pavarur nga TIA, siç e specifikon dhe neni 3.3 i Marrëveshjes, të respektojë të drejtat e detyrimet që burojnë nga Ligji 9312/2004 përpara palëve të treta sikur të ishte vetë TIA.*

*Sipas nenit 17 të Marrëveshjes, është përgjegjëse të veprojë në çdo kohë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat në fuqi, të zbatojë praktikën e rekomanduar në përgjithësi dhe ato të dedikuara për aeroportin. Në këtë drejtim, Shoqëria ka detyrimin të marrë parasysh, Vendimin Nr. 1503, datë 19.11.2008, që përcakton rregullat mbi shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar. Sikurse edhe në investimet e reja (parkimi i ri) do të sigurojë si numrat e vendparkimeve të rezervuar falas ashtu edhe të gjitha kushtet e aksesueshmërisë për këtë kategori.*

*Sa më sipër, TIA po monitoron nga afër aktivitetin e Shoqërisë duke u përpjekur në këtë mënyrë të sigurohet për cilësinë e shërbimit të ofruar pasagjerëve dhe të mbështesë garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në Aeroportin e Tiranës”.*

Ndërsa nga ana e Shoqërisë Star Parking Albania shpk, nuk u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion shtesë.

4. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 932/7 prot., datë 07.11.2023 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 21.11.2023.

<sup>6</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me Nr. 932/8 prot., datë 08.11.2023.



Seanca dëgjimore u zhvillua datën 21.11.2023, ora 10:00, me pjesëmarrjen e: Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga Drejtorja Ekzekutive S. L; Shoqërisë Tirana International Airport shpk, përfaqësuar nga juristja, A. F. dhe Shoqërisë Star Parking Albania shpk, përfaqësuar nga Drejtori Operacional i saj, T. K.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesja e Fondacionit “Së Bashku”, deklaroi se u qëndronte pretendimeve për diskriminim nga ana e TIA-s dhe Star Parking Albania shpk, lidhur me tarifat e parkimit për personat me aftësi të kufizuara; shtimin e numrit të vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, në afërsi të hyrjes së aeroportit, të cilat të përmbushin plotësisht standardet e aksesueshmërisë dhe parkimin pa pagesë të personave me aftësi të kufizuara edhe për periudha afatgjata, disa ditore.

Përfaqësuesja e TIA-s informoi Komisionerin sërish se, referuar kontratës së koncesionit, përgjegjëse për administrimin e shërbimeve të parkimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës është Shoqëria Star Parking Albania. Pra, Star Parking Albania gëzon të drejta të plota të menaxhimit të parkimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Përfaqësuesi i Star Parking Albania mbështeti dhe pranoi faktin që shoqëria që ai përfaqëson është përgjegjëse për administrimin e shërbimeve të parkimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe për këtë nuk duhet të ngarkohet me përgjegjësi TIA. Në vijim, ai iu drejtua palës ankuese, duke i kërkuar ndjesë për sjelljen e punonjësve të Star Parking Albania, si dhe theksoi se situata të tilla nuk kanë ndodhur më parë, megjithatë për këtë rast i është tërhequr vëmendja në rrugë verbale punonjësve në fjalë.

Parkimi i personave me aftësi të kufizuara në ambientet e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, theksoi ai, ka qenë dhe është pa pagesë dhe pa limit kohor në të gjithë territorin që mbulon shoqëria. Për shkak të rritjes së fluksit të pasagjerëve në aeroport, ndodh që në vendet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, pa të drejtë të parkojnë persona të tjerë. Këtë nuk ka arritur ta kontrollojë stafi i shoqërisë në të gjitha rastet për shkak të fluksit të madh të automjeteve në parkim. Aktualisht, theksoi përfaqësuesi i shoqërisë, po ndërtohet një parkim i ri në ambientet e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, i cili brenda një afati rreth 3-4 mujor do të jetë i aksesueshëm dhe do të ketë një numër më të madh për personat me aftësi të kufizuara, 12 vende të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, pas përfundimit të tij, do të bëhet një rikonfigurim i parkimit ekzistues, pasi ai ka qenë i tillë që kur është ndërtuar aeroporti dhe nuk është ndërhyrë më në të. Parkimi i mbuluar P1, sipas shoqërisë ka 250 vende parkimi, nga të cilat 4 vende të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara.

Në përfundim, përfaqësuesi i shoqërisë nuk arriti të vërë në dispozicion një dokument apo akt tjetër ku të ishin parashikuara lehtësirat për vendparkimet e personave me aftësi të kufizuara, por theksoi se është ngritur një grup në aplikacionin Whatsapp, përmes së cilit komunikohet çdo person me aftësi të kufizuara që hyn dhe del nga ambientet e parkimit, si dhe konfirmohet

përrjashtimi nga tarifatat e tij. Për këtë, ai vuri në dispozicion të Komisionerit disa komunikime në grupin e Whatsapp-it.

Bazuar në pikën 9, të nenit 33, të LMD, përcaktohet se:

*“9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.”* Bazuar në këtë kompetencë ligjore, si dhe duke vlerësuar qëndrimin e palëve gjatë seancës dëgjimore, Komisioneri i'u parashtrori palëve nëse ata mund të arrijnë një marrëveshje me pajtim në lidhje me problematikën e parashtruar dhe qëndrimet e tyre në rast të arritjes së një marrëveshje t'ia komunikoni Komisionerit.

Në përfundim, pala ankuese nuk ra dakord me arritjen e një marrëveshje pajtimi dhe kërkoi që të vijojë me shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës.

5. Në vijim të seancës, nëpërmjet e-mail-it datë 21.11.2023, drejtuesja e Fondacionit “Së Bashku”, S. L., vuri në dispozicion të Komisionerit:
  - 1 (një) faturë parkimi të datës 11.09.2023 në vlerën 200 lekë, paguar në parkimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës;
  - 1 (një) biletë kthimi të datës 16.09.2023, nga aeroporti i Mynih, Gjermani;
  - 1 (një) itinerar të printuar udhëtimi, ku citohet nisja nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës në orën 11:50, datë 11.09.2023 dhe mbërritja në Aeroportin e Mynihut në të njëjtën datë, ora 13:45;
  - Dokumentacion mbi pjesëmarrjen në takimin e mbajtur në Portugali, në datat 14-15.09.2023.
  
6. Përmes e-mail-it datë 22.11.2023, Shoqëria Star Parking Albania dërgoi parashtrime shtesë pas seancës dëgjimore, duke vendosur në dispozicion të Komisionerit:
  - Rregulloren e miratuar mbi aksesueshmërinë e parkimeve të personave me aftësi të kufizuar dhe foto ku ajo është e publikuar në ambientet (në hyrje-daljet dhe kabinat ku bëhen pagesat e parkimit) parkimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës;
  - Komunikimet në aplikacionin Whatsapp në të cilën pasqyrohen konfirmimet për mospagesë të parkimit nga ana e personave me aftësi të kufizuara;
  - Fatura me shënimet përkatëse për persona të paraqitur pranë sporteleve të shoqërisë dhe që nuk i janë faturuar vlera e parkimit. (Shoqëria ka theksuar faktin që periudha e këtyre faturave është përpara se të ndodhte rasti konkret).
  - Foto nga sportelet ku janë afishuar rregullorja e sipërmendur.
  
7. Me anë të e-mail-it datë 22.11.2023, Komisioneri i përcolli subjektit ankues për konsultim parashtrimet dhe provat e vëna në dispozicion nga ana e Shoqërisë Star Parking Albania.

Në përgjigje të materialeve të sipërcituara, me datë 23.11.2023, Fondacioni “Së Bashku”, parashtroi disa pyetje për Shoqërinë Star Parking Albania, duke cituar:

- *“Dokumenti i parë është padyshim pjesë e një fature, sepse ka shumën 150 lekë kështu që është i pavlefshëm si provë, sepse qartazi personi e ka paguar dhe shënimi mbi të nuk do të thotë asgjë. Nëse vini re faturën time që ju dërgova, është e ngjashme me të. Dhe është e datës 20 nëntor. Bileta e dytë e nënshkruar duket se është në rregull.*
- *Pamjet e ekranit të whatsapp-it nuk kanë një datë dhe për mendimin tim janë mjaft të fundit nëse jo të ditëve të fundit. Dhe meqë mediat sociale mund të jenë dëshmi, ju lutemi hidhini një sy pamjeve të ekranit nga faqja ime në Facebook, të cilat kanë një datë dhe një emër, duke treguar një realitet tjetër.*
- *Rregullorja tregon se ata nuk kuptojnë asgjë për të drejtat e aftësisë së kufizuar. Titulli i rregullores nuk ka asnjë lidhje me përmbajtjen e saj. Aksesueshmëria është një temë tjetër dhe rregullat për parkimin e personave me aftësi të kufizuara janë temë e ndryshme. Rregullat janë gjithashtu të kohëve të fundit dhe shumë të ngurta. Po për të udhëtuar me një makinë me qira? Po udhëtarët e huaj me aftësi të kufizuara, si i përfitojnë të njëjtat të drejta?*
- *A mund të pyesni Star Parking Albania se sa persona me aftësi të kufizuara kanë parkuar falas nga janari deri në gusht 2023 dhe a mund të pyesni aeroportin e Tiranës se sa persona me aftësi të kufizuara kanë kërkuar asistencë për fluturimet nga janari në gusht 2023? Unë mendoj se këto të dhëna mund t'ju ndihmojnë të arrini një përfundim”.*

8. Me e-mail-in datë 12.12.2023, Komisioneri i përcolli Shoqërisë Star Parking Albania për konsultim parashtimet dhe provat e vëna në dispozicion nga ana e subjektit ankues.

Në vijim të komunikimit, me anë të e-mail-it datë 13.12.2023, Shoqëria Star Parking Albania, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara nga ana e subjektit ankues duke theksuar se:

- *“Në lidhje me faturën e datës 19.06.2023, ju bëjmë me dije se vlera e faturës gjenerohet direkt nga sistemi duke llogaritur kohën e qëndrimit të mjetit në parkim (referuar orës së hyrjes dhe daljes nga parkimi), pasi sistemi nuk është i përshtatur për personat e përjashtuar nga tarifa e parkimit. Në këtë kuptim, shënimi sipër “OK” tregon që kjo faturë nuk është paguar. Ndërsa dokumenti i dytë është i pajisur me “barcode” shërben për hapjen e traut të parkimit me qëllim daljen e mjetit dhe si i tillë nuk ka të shkruar tarifë.*
- *Pamjet “screenshot” të programit WhatsApp janë të kohëve të fundit në përputhje me rregulloren e hartuar si reflektim i mbledhjes së fundit të datës 21.11.2023 të thirrur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se nuk disponojmë komunikime më të hershme për shkak të memorjes së kufizuar të aparatëve celularë. Sa i takon pretendimeve të personave të ndryshëm në profilin e S. L. në rrjetin social “facebook”, ato ngelen komente dhe dëshmi të dhëna në rrjete sociale dhe si të tilla mbeten të pakonfirmuara.*

- *Sjellim edhe njëherë në vëmendjen Tuaj, se hartimi i rregullores dhe afishimi në vende të dukshme është reflektim i mbledhjes së datës 21.11.2023 të thirrur nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjatë hartimit të kësaj rregullore jemi kujdesur tu referohemi termave ligjore për të shmangur çdo lloj keqkuptimi. Në referencë të ligjit Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, neni 3 pika 1 përcakton se: “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”, ndërsa në nenin 4 të po këtij ligji parashikohen parimet bazë, ku në pikën “ç” përcaktohet “garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve”. Gjithashtu në hartimin e kësaj rregullore, jemi kujdesur të kemi një gjuhë të thjeshtë, konçize dhe të kuptueshme nga të gjithë, si dhe i jemi referuar legjislacionit shqiptar në lidhje me personat me aftësi të kufizuara që kanë përfituar statusin me vendime të komisioneve të posaçme mjeksore sipas këtij legjislacioni. Në kuptim të ligjit, automjetet e përdorura nga personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë të përshtatura për këta persona dhe të administruara nga institucionet përkatëse, (ligji Nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar, neni 16, ligji Nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës” i ndryshuar, neni 8). Megjithatë në frymën e rregullores prevalojnë dokumentat e paraqitura nga individit. Sa i takon pretendimit lidhur me përfitimin e të drejtave nga persona me aftësi të kufizuara të cilët janë shtetas të huaj, theksojmë se, rregullorja është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe nuk bën dallime lidhur me shtetësinë e individit për sa kohë ai disponon dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga ligji.*
- *Në lidhje me këtë pretendim, ne gjykojmë se është jashtë objektit të çështjes dhe për më tepër këto asosacione nuk mund të çojnë në asnjë përfundim mbi çështjen në fjalë. Ato janë dhe mbeten thjeshtë aludime, hamendësime që nuk mund të merren për bazë për të nxjerrë përfundime të sakta.*

*Në përfundim, shprehim gatishmërinë për të marrë të gjitha masat e nevojshme për përafrimin e kushteve me legjislacionin në fuqi, sikurse edhe e kemi treguar me veprime konkrete pas mbledhjes së datës 21.11.2023”.*

## **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.**

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar.

Pala ankuese në çështjen në objekt shqyrtimi është një organizatë jofitimprurëse, e cila ushtron veprimtarinë e saj ndër të tjera në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Pala ankuese pretendon se zënia dhe mungesa e

vendparkimeve të mjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara në territorin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, diskriminon personat me aftësi të kufizuar.

Fillimisht subjekti ankues, Fondacioni “Së Bashku”, paraqiti ankesën pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me objekt, diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara që marrin shërbimin pranë Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, duke iu mohuar e drejta për të parkuar automjetet e tyre pa pagesë në parkingun e TIA-s dhe vendet e parkimit që janë të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, zihen nga persona të tjerë që nuk janë me aftësi të kufizuara. Bashkëngjitur ankesës, Fondacioni “Së Bashku” nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë fakt apo provë për të vërtetuar pretendimet e ngritura në ankesë. Për këtë qëllim, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë<sup>7</sup> për plotësimin e informacionit të munguar.

Në përgjigje<sup>8</sup> të kërkesës së sipërcituar, Fondacioni “Së Bashku”, vuri në dispozicion të Komisionerit disa foto të 5 vendparkimeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, ku ishin parkuar automjete nga qytetarë të ndryshëm. Gjithashtu, subjekti ankues sqaroi se nuk administronte dokumente të tjera për të provuar pretendimet e ngritura në ankesë.

Nga informacioni i administruar<sup>9</sup> rezulton se, pretendimet e objektit të ankesës, që janë vendparkimet e rezervuara për personat me aftësi të kufizuara, janë shërbime që mbulohen dhe administrohen nga Shoqëria Star Parking Albania shpk.

Referuar Kontratës së Koncesionit lidhur me datë 01.07.2015 me shoqërinë Star Parking Albania shpk, Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës i ka dhënë me nën-koncesion kësaj të fundit, të drejtën e menaxhimit, instalimit, përditësimit/përmirësimit dhe operimit të përhershëm të parkimit në Aeroportin e Tiranës, ku përfshihet instalimi dhe komisionimi i gjithë sistemit dhe pajisjeve të parkimit, operimi/administrimi, vendosja e tarifave, aksesit si dhe përdorimi i faciliteteve të parkimit.

Neni 3.3 i Kontratës përcakton se Shoqëria në drejtim të ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve që jepen me anë të kësaj Kontrate është një kontraktor/pavarur, që vepron në emër dhe për llogari të tij dhe nuk do të veprojë si agjent ose partner i TIA-s. Pra, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, përgjegjëse e vetme në administrimin e parkimit në aeroport rezulton të jetë Shoqëria Star Parking Albania shpk. Sakaq, subjekti përgjegjës për administrimin e vendparkimeve në territorin e TIA-s, rezulton të jetë Shoqëria Star Parking Albania shpk. Në këtë kuptim, analiza në vijim do të bëhet referuar veprimeve apo mosveprimeve të ndërmarra nga ana e Shoqërisë Star Parking Albania dhe jo subjekteve të tjera ndaj të cilave është paraqitur ankesa si: Tirana International Airport apo Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

---

<sup>7</sup> Përmes e-mail-it datë 11.08.2023.

<sup>8</sup> Përmes e-mail-it datë 11.08.2023.

<sup>9</sup> Referuar fotografive të dërguara nga Fondacioni “Së Bashku” dhe provave të administruara nga palët gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Nga provat e administruara, u evidentua gjithashtu se në parkimin P1 të TIA-s, për të cilin pala ankuese kishte paraqitur edhe pretendimet e saj në ankesë përmes provave (fotografive), nga 250 vende parkimi, 4 prej tyre ishin të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Shoqëria Star Parking Albania deklaroi se ishte në përfundim të punimeve të një parkimi tjetër në territorin e TIA-s, në të cilin do të shtoheshin edhe 12 vendparkime të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara. Pas përfundimit të punimeve të këtij projekti, do të vijojej me riorganizimin e të gjithë vendparkimeve të TIA-s në zbatim dhe në përmbushje të kriterëve dhe parashikimeve në lidhje me sigurimin e parkimeve për personat me aftësi të kufizuara të parashikuara nga VKM-të nr. 1503/2008 dhe nr. 1074, datë 23.12.2015.

### **Kuadri ligjor i zbatueshëm.**

Me ligjin nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>10</sup>*, Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”<sup>11</sup>*. Bazuar në nenin 116, të Kushtetutës, ky akt ndërkombëtar i të drejtave të njeriut jo vetëm që bëhet pjesë e të drejtës së brendshme e detyrueshme për t’u zbatuar, por duke patur edhe përparësi ndaj ligjeve të tjera.

KDPAK përfaqëson standardin më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Qëllimi i kësaj Konvente është të promovojë, mbrojë dhe sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektin e dinjitetin e tyre të lindur (neni1).

Konventa nuk jep një përkufizim të aftësisë së kufizuar, por pranon se aftësia e kufizuar është një koncept evolues dhe se aftësia e kufizuar rezulton nga ndërveprimi ndërmjet personave me dëmtime dhe barrierave/pengesave të qëndrimit/mentalit dhe ambjentit që pengojnë pjesmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët (Preambula e KDPAK, gërma “e”). Rrjedhimisht në qendër të vëmendjes nuk duhet të jetë paaftësia/paaftësitë e mundshme, por kufijtë që ngre shoqëria, duke penguar gëzimin e të drejtave. Nga ana tjetër KDPAK pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara.

Me qëllim që të bëhet e mundur që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të mund jetojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë plotësisht në të gjitha aspektet e jetës, shtetet duhet të marrin masat e duhura për të siguruar akses për personat me aftësi të kufizuar, në baza të barabarta me të tjerët, në ambjentet fizike, transport, informacion dhe komunikim, përfshirë dhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në mjete apo shërbime të tjera të hapura apo të siguruar për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale. Këto masa,

<sup>10</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KDPAK.

<sup>11</sup> Ratifikuar me ligjin nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.



të cilat duhet të përfshijnë identifikimin dhe eliminimin e pengesave dhe barrierave për mundësimin, zbatohen ndër të tjera për: a) ndërtesa, rrugë, transport dhe mjete të tjera në ambiente të brendshme apo të jashtme, përfshirë shkollat, strehimin, shërbime mjekësore apo vendet e punës; (neni 9/1 KDPAK).

Aksesueshmëria ose e thënë ndryshe heqja e pengesave/barrierave, është një parakusht që personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në baza të barabarta me të tjerët në shoqëri, për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të gëzuar gjithë të drejtat dhe liritë e parashikuara. Për rrjedhojë, aksesueshmëria është ngushtësisht e lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara. Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar. Për rëndësinë që aksesueshmëria paraqet, parashikohet nga KDPAK si një e drejtë më vete në nenin 9, por edhe si një nga parimet themelore që përshkon të gjithë Konventën, sipas nenit 3.

Në pikën 2, të nenit 9, të KDPAK, parashikohet se: “2. *Shtetet palë duhet gjithashtu të marrin masat e duhura: a) për të zhvilluar, shpallur dhe monitoruar implementimin e udhëzimeve dhe standardeve minimale për mundësimin e mjeteve dhe shërbimeve të hapura apo të siguruara për publikun;....*”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*” (në vijim ligji nr. 93/2014). Në nenin 3, pika 9, të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se: “9. “*Persona me aftësi të kufizuara*” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”.

Në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 93/2014, përcaktohet: “*Aksesueshmëri*” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve”. Më tej në pikën 3, të këtij neni parashikohet se: “ 3. “*Pengesat*” nënkupton: a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore; b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar; c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike; ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Në përputhje me qasjen e KDPAK edhe ky ligj sanksionon se aksesueshmëria është një nga parimet e këtij ligji (neni 4/ç) dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, ndër të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën komunitare dhe qytetare (neni 5/1<sup>12</sup>).

---

<sup>12</sup> “*Jetesa e pavarur u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët, kur është nevoja, nëpërmjet ofrimit të mbështetjes dhe të ndihmës, bazuar në zgjedhjen dhe aspiratat e vetë individit për nevojat e jetës*”

Për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1074/2015). Ky vendim përcakton masat për zbatimin dhe unifikimin e rregullave, në bazë të të cilave mënjanohej pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime për personat me aftësi të kufizuara. Sipas këtij vendimi, janë pengesa infrastrukturore: a) pengesat fizike si burim vështirësish për lëvizjen e kujtudo dhe në mënyrë të veçantë të atyre që, për çfarëdolloj arsyeje, kanë një aftësi lëvizëse të kufizuar, të përhershme ose të përkohshme; b) pengesat që kufizojnë ose pengojnë këdo në përdorimin komod dhe të sigurt të hapësirave, pajisjeve e të pjesëve përbërëse; c) mungesa e mjeteve dhe e sinjalizimeve që lejojnë orientimin dhe njohjen e vendeve e të burimeve të rrezikut për këdo dhe, në veçanti, për personat me shikim apo dëgjim të kufizuar (Kreu I, pika 3). Ky vendim është i detyrueshëm si ndaj sektorit publik ashtu edhe atij privat dhe përfshin të gjitha ndërtesat e reja ashtu edhe ato ekzistuese, e në mënyrë të veçantë ato mjedise ku ofrohen shërbime publike, parqet, sheshet e rrugët (Kreu I, pika 4).

Sipas pikës 2, të kreut 2, të kësaj VKM-je, çdo kërkesë teknike për përshtatshmërinë e objekteve të reja dhe atyre ekzistuese, parqeve, shesheve dhe rrugëve zbatohet sipas dispozitave të parashikuara në vendimin nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara” (në vijim VKM nr. 1503/2008). Ndër të tjera, në këtë rregullore parashikohet sa më poshtë vijon:

#### *“PJESA I*

*Zbatimi i rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*

#### *Kreu I*

*Të përgjithshme*

#### *Neni 1*

*Objekti, qëllimi dhe fusha e aplikimit*

- a. *Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave teknike për eliminimin e pengesave që përcaktohen si “barriera arkitektonike”.*
- b. *Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike.*
- c. *Fusha e aplikimit të saj shtrihet në:*
  - *të gjitha objektet publike të reja të ndërtuara me fondet e buxhetit të shtetit apo private si dhe në objektet private, që ndërtohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;*

---

*së përditshme, përfshirë aksesin në strehim, transport, shëndetësi, kujdes social, arsimim, punësim dhe shërbime e mundësi të tjera, si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në të gjitha sferat e jetës, përfshirë jetën familjare, komunitare dhe qytetare”.*

- *godinat dhe hapësirat publike, ndërtimet e reja me karakter të përkohshëm, ose në ato ekzistuese nëse do t'i nënshtrohen rikonstruksionit;*
- *ndërtesat dhe hapësirat publike që i nënshtrohen çfarëdolloj ndërhyrjeje ndërtimi që ka të bëjë me heqjen e kufizimit të mundësisë së pamjes dhe fushëpamjes, që të paktën, qoftë edhe pjesërisht, është pjesë e ndërhyrjes;*
- *ndërtesat dhe hapësirat publike që janë, tërësisht ose pjesërisht, objekt i ndryshimit të destinacionit nëse do të jetë në përdorim publik, si edhe për shërbime të veçanta për përdorim publik.*

## *Neni 2*

### *Përshatja e objekteve ekzistuese*

1. *Në ndërtesat dhe hapësirat publike ekzistuese, edhe pse nuk janë objekt ristrukturimi ose riorganizimi funksional, duhet të evidentohen dhe të llogariten të gjitha mundësitë për përshatje, të cilat mund të përmirësojnë shfrytëzimin në bazë të kërkesave që janë në këtë rregullore.*
2. *Çdo ndërtesë duhet të pajiset, nën kujdesin e administratorit publik apo privat të ndërtesës, me një sistem thirrjesh që të aktivizojë një shërbim ndihme në mënyrë të tillë që t'u lejojë personave me aftësi të kufizuara lëvizjen ose ndijimin e shërbimit me zë.*
3. *Në objektet e banimit publike/private dhe në banesa vetjake, përfshi edhe ato të hapura për publikun, aplikohen rregullat dhe standardet e përcaktuara në këtë rregullore.*
4. *Nuk mund të ofrohen kontribute ose lehtësime nga ana e shtetit dhe e enteve të tjera publike për realizimin e punimeve publike ose të shërbimeve publike në kundërshtim me këto rregulla dhe standarde.*
8. *Eliminimi i barrierave - është rezultat i aplikimit të zgjedhjes teknike në projektim dhe ndërtim të objektit me të cilat PAK-ja siguron lëvizjen pa pengesë, qëndrimin dhe kryerjen e punëve në to në të njëjtin nivel sikurse personat e tjerë.*
9. *Elementet e eliminimit të barrierave - janë pjesë të objekteve ndërtimor ose pajisje, të cilat sigurojnë eliminimin e barrierave, të përcaktuara me këtë rregullore. Këto elemente ose pajisje janë: rampa, shkallë, ashensor, platforma vertikale ngritëse, platforma të pjerrëta lëvizëse palosëse, detaje në hapësirat hyrëse, doreza e derës dhe dritares, pulti, tabela e shpalljeve, plani orientues për lëvizje në ndërtesë, semafori, pajisje komunikimi, hapësira dhe pajisje ËC, banja, kuzhine, dhoma, klasa, ambiente pune, banimi/apartamenti, kafeneja, restoranti, gardëroba, kabina dushi, pishina, vendet në tribuna, kabina telefonike, tekstofoni, bankomati, instalimet elektrike, stacioni dhe peroni, vend parkingu, sipërfaqja publike për këmbësor, kalimi për këmbësor, ishulli për këmbësorë dhe udhëkryqi.*

Në nenet 12 dhe 13, të pjesës së parë të rregullores, për parkimet parashikohet se:

### *“Neni 12, Parkimet;*

1. *Për parkimet vlejné rregullat e dhëna në pikën 2.3 të nenit 4 dhe standardet e dhëna në pikën 3.3 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.*

2. Për vendet e rezervuara të vendosura paralelisht me drejtimin e lëvizjes, gjerësia duhet të jetë e tillë që të lejoj kalimin e një personi në karrige me rrota në mes të dy makinave. Kjo kërkesë është e plotësuar nëse gjatësia e vendit të makinës nuk është më e vogël se 6 m. Në një rast të tillë, gjerësia e një vendi të rezervuar për makinë nuk tejkalon gjatësinë e një vendi të zakonshëm për makinë (250 cm).
3. Vendet e rezervuara mund të kufizohen me vendosjen e mjeteve bllokuese të posaçme.

Neni 13, Qarkullimi dhe qëndrimi i mjeteve në shërbim të personave me aftësi të kufizuar

1. Personat mbajtës të shenjave dalluese, të klasifikuar sipas nenit 14 të pjesës së parë të kësaj rregulloreje, u lejohet nga autoritetet kompetente, qarkullimi dhe qëndrimi i mjetit në shërbim të tyre:
  - në vendet që nuk përbëjnë pengesë për trafikun;
  - në raste të ndërprerjes ose kufizimit të qarkullimit për motive të sigurisë publike;
  - në raste të ndërprerjes ose kufizimit të qarkullimit për interesa publike ose për nevoja me karakter ushtarak;
  - kur janë vendosur kushte ose ndalime të karakterit të përhershëm ose të përkohshëm;
  - kur ndalohet dhe kufizohet qëndrimi.
5. Në vendet e parkimeve ose vendet e qëndrimit, të pajisur me mekanizma të kontrollit të kohëzgjatjes së qëndrimit për ruajtjen e makinave, të paktën 1 në çdo 50 vende ose në fraksion të 50 vendeve të disponueshme duhet të jenë të rezervuara falas për personat mbajtës të shenjave dalluese.
6. Vendet e cituara në pikën 5 të këtij neni duhet të jenë të shënuara me shenjën e përkatëse të arritshmërisë.

Në nenin 4, të Kreut II, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen kriteret e projektimit për arritshmërinë:

*“1.14 Garazhet, vendi i të cilave duhet të lidhet me hapësirat e jashtme dhe me pajisjet e ngritjes, të përshtatshme për përdorim nga personat në karrige me rrota.*

*Hapësira e rezervuar për ndalim qëndrimin e makinave në shërbim të personave me aftësi të kufizuara, duhet të ketë dimensione të tilla që të lejojë edhe lëvizjen e këtyre personave në kohën e hipjes në mjet. Ajo duhet bërë e dukshme nëpërmjet sinjaleve përkatëse horizontale dhe vertikale sipas standardeve të dhëna në pikën 2.14 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.*

*2.3 Parkimi konsiderohet i arritshëm nëse sipërfaqja në të cilën lëviz personi në karrigen me rrota është në të njëjtin plan me sipërfaqet e këmbësorëve të shërbimit ose lidhja midis tyre, në raste disnivelesh që kalojnë kufirin e lejuar, kryhet nëpërmjet platformave të pjerrëta ose të pajisjeve të përshtatshme të ngjitjes, sipas standardeve të dhëna në pikën 3.3 të nenit 8 të pjesës së dytë të kësaj rregulloreje.*

*Hapësira e rezervuar e ndalimit të makinave të personave me aftësi të kufizuara duhet të ketë të njëjtat karakteristika si në pikën 1.14 të këtij neni.*

*3. Sinjalistika në ndërtesa dhe nëpër hapësirat e arritshme duhet të vendoset në mënyrë të dukshme që të shihen lehtësisht tabelat me udhëzime për orientimin dhe shfrytëzimin e hapësirave të ndërtuara, duke dhënë informacionin e duhura mbi mënyrën e hyrjes nga personat me aftësi të kufizuara ose paaftësi lëvizëse. Në raste të tilla tabelat treguese duhet të kenë edhe simbolin tregues ndërkombëtar të arritshmërisë, shtojca A”.*

Në Kreun IV, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohen standardet dhe zgjidhjet teknike të detyrueshme për t’u zbatuar me qëllim për të garantuar mundësinë e përdorimit të hapësirave të jashtme nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Konkretisht në nenin 8, të VKM së sipërcituar, përcaktohen në mënyrë të detajuar standardet funksionale dhe të përmasave në hapësirat e jashtme, të detyrueshme për t’u respektuar. Kështu në pikën 3.3 përcaktohet:

*“Kreu IV, Standardet dhe zgjidhjet teknike.*

*3. Hapësirat e jashtme.*

*3.3 Parkimet duhet të vendosen në masën minimale 1 në çdo 50 vende makinash, me gjerësi jo më të vogël se 320 cm dhe e rezervuar falas për makinat e personave me aftësi të kufizuara. Të ashtuquajtura vende makinash, të sinjalizuara, caktohen në ngjitje të vendkalimeve të këmbësorëve dhe në afërsi të hyrjes së ndërtesave ose pajisjeve. Me qëllim lehtësimin e transferimit të personit në karrige me rrota në kushte të njëjta atmosferike, preferohet që vendet e makinave të rezervuara të jenë të pajisura me mbulesë. Vendparkimi për PAK duhet të vendoset afër hyrjes së ndërtesës. Vendparkimi për automjete, kur parkimi bëhet pjerrtas apo për së gjati në raport me trotuarin për këmbësorët, madhësia e tij duhet të jetë 370 x 500 cm, figura 32 shtojca B. Nëse vendparkimi është për dy makina madhësia e tij duhet të jetë 590 x 500 cm me distancë ndërmjet tyre 150 cm, figura 33, shtojca B. Dalja nga vendparkimi dhe hyrja në trotuaret e këmbësorëve kryhet me një pjerrësi 10% dhe gjerësi 120 cm”.*

Në nenin 26, të Kreut V, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, përcaktohet se: *“Në parkimet dhe garazhet publike, si dhe pranë objekteve ndërtimore 5% e vendeve përshtaten në raport me numrin total të vend parkimeve, por jo me pak se një”.*

Në figurën 3, të shtojcës A, të pjesës së dytë, të VKM nr. 1503/2008, ilustruhet me figurë (1.25) shenja e parkingut të përshtatur për personat me AK, ndërsa në figurat 32 dhe 33 të shtojcës B, ilustrohen vendet e parkimit në varg dhe me hapësirë në mes, për personat me AK.

Referuar parashikimeve të mësipërme të bëra në VKM nr. 1503/2008, ekzistojnë rregulla dhe standarde të mirëpërcaktuara dhe të detyrueshme për zbatim, që duhet të përmbushin parkimet për personat me AK, për të eliminuar pengesat/barrierat dhe për të garantuar aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Mbështetur në pretendimet e depozituara në ankesë dhe provave të vëna në dispozicion nga pala ankuese, rezulton se ajo i referohet parkimit P1 të TIA-s. Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se:

- Parkimi P1 i Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, përbëhej nga 250 vende parkimi në total, nga të cilat 4 prej tyre ishin të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, Pra rezulton se numri i vendparkimeve për personat me aftësi të kufizuara është 1 më pak se parashikimet e nenit 13, pika 5 të VKM-së nr. 1503/2008;
- Nga informacioni i vënë në dispozicion rezulton se përpara dhe pas periudhës në të cilën është paraqitur ankesa, Shoqëria Star Parking Albania shpk, ka përcjellë pranë Komisionerit prova me anë të të cilave evidentohet se automjetet e përdorura nga ana e personave me aftësi të kufizuara kanë parkuar pa pagesë në territorin e administruar prej saj, pavarësisht nëse kanë qëndruar për një periudhë kohore afatshkurtër apo afatgjatë;
- Sa i përket zënies së vendparkimeve të rezervuara nga ana e qytetarëve të tjerë, Shoqëria pranoi faktin që një gjë e tillë ka ndodhur si rezultat i fluksit të lartë të pasagjerëve që udhëtojnë përmes TIA-s dhe nuk kanë arritur t'i mbajnë të lira për personat me aftësi të kufizuara;
- Pavarësisht faktit që Shoqëria Star Parking Albania shpk, nuk kishte një rregullore apo një akt të miratuar lidhur me procedurën që ndiqet për të përjashtuar nga tarifat e parkimit personat me aftësi të kufizuar, nga ana e saj u vunë në dispozicion prova dhe fakte me anë të të cilave dokumentohet se ata nuk kanë parkuar me pagesë në territorin e TIA-s;
- Pas marrjes së ankesës dhe shqyrtimin e saj, Shoqëria Star Parking Albania miratoi një Rregullore të posaçme lidhur me procedurat që duhet të ndiqen nga punonjësit e saj për parkimin e mjeteve për personat me aftësi të kufizuara në territorin e TIA-s. Pas miratimit të këtij dokumenti, u konstatua se Shoqëria e publikoi në ambientet e parkimit (në kabinat ku bëhen pagesat, në hyrje-daljet e parkimit)
- Gjithashtu nga ana e Shoqërisë Star Parking Albania u theksua fakti që në përfundim të punimeve të parkimit të ri të TIA-s do të bëhet një riorganizim apo rishpërndarje e vendparkimeve të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara;

Pavarësisht sa më sipër, rezulton se:

- Fondacioni “Së Bashku”, në cilësinë e ankuesit, ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit si organizatë me interesa legjitime, në emër të një grupi personash të cilët pretendojnë një situatë diskriminuese nga ana e TIA-s dhe shoqërisë që administron parkimin e aeroportit, Shoqëria Star Parking Albania;
- Nga ana e subjektit ankues në momentin e depozitimit të ankesës, nuk është depozituar asnjë provë apo fakt me anë të të cilës të vërtetohen pretendimet e ngritura të diskriminimit, në lidhje me vendosjen e tarifave të parkimit për personat me aftësi të kufizuara në parkimin e TIA-s. Provat e vetme të depozituara nga ana e subjektit ankues në momentin e plotësimit të ankesës janë disa foto të vendparkimeve të TIA-s,



në të cilat evidentohet se janë të parkuara automjete, por që nuk identifikohen nëse i përkasin personave me aftësi të kufizuara ose jo;

- Nga ana e subjektit ankues nuk u arrit të dokumentohej apo provohej se grupi i personave që përfaqëson pranë Komisionerit, pra personat me aftësi të kufizuara janë vënë përpara detyrimit nga ana e Shoqërisë Star Parking Albania të paguajnë për parkimin e mjeteve të tyre në territorin e TIA-s;
- Nga ana e përfaqësueses së Fondacionit “Së Bashku”, u vunë në cilësinë e provës disa video në të cilat evidentohet se mes saj dhe një punonjësi të Shoqërisë Star Parking Albania, diskutohej lidhur me tarifat e parkimit, por edhe në këtë rast, ajo e ka përfituar parkimin pa pagesë në territorin e TIA-s. Referuar situatës së ndodhur, nga ana e përfaqësuesve të Shoqërisë Star Parking Albania u kërkua ndjesë, gjatë seancës dëgjimore të realizuar pranë KMD-së, si dhe u theksua se i është tërhequr vëmendja punonjësve në fjalë për situatën e krijuar;
- Gjithashtu, nga ana e Fondacionit “Së Bashku” u vunë në dispozicion disa komente të marra nga rrjeti social Facebook, ku persona të ndryshëm në katër raste kishin shprehur shqetësimin e tyre se TIA i ka vendosur tarifa parkimi personave me aftësi të kufizuara. Nga kqyrja e tyre nuk evidentohet nëse ata i përkisnin kategorisë së personave me aftësi të kufizuara apo koha dhe momenti kur ata janë vënë përpara përgjegjësisë për të paguar parkimin në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Pra nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për të dokumentuar pretendimet e tyre.
- Pavarësisht situatës së sipërcituar, ankesa e paraqitur pranë Komisionerit lidhet me pretendimin për diskriminim të një grupi personash, për të cilin nuk u vunë në dispozicion prova të mjaftueshme për të vërtetuar një pretendim të tillë.

Për rrjedhojë, në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nga ana e Fondacionit “Së Bashku” nuk u administruan prova të mjaftueshme që personat me aftësi të kufizuara të jenë ekspozuar ndaj një qendrimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë. Në këtë kuptim dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjektet ankues nuk i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Shoqërisë Star Parking Albania shpk, si person juridik i cili ka nën administrim Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqërisë Tirana International Airport shpk apo Shoqërisë Star Parking Albania shpk, për shkak të aftësisë së kufizuar të ankuesve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, përfaqësuar nga Fondacioni “Së Bashku”, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqërisë Tirana International Airport shpk dhe Shoqërisë Star Parking Albania shpk, për shkaqet e pretenduara në ankesë.
2. Rekomandohet Shoqëria Star Parking Albania shpk, të marrë masat për organizimin e parkimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës në respektim të parashikimeve të Vendimit nr. 1503, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*”.
3. Rekomandohet Shoqëria Star Parking Albania shpk, të marrë masa që vendparkimet e dedikuara për personat me aftësi të kufizuara të mund të shfrytëzohen vetëm prej tyre.
4. Në referencë të pikave 1, 2 dhe 3, Shoqëria Star Parking Albania shpk, të marrë masat për trajnimin e stafit të shërbimit, në lidhje me çështjet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)